



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0359

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj - Mexhuani dhe Vedat Poterqoi, Anëtarë duke vendosur sipas ankesës së OE Double I&I SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Universitetit” me numër të prokurimit 10208-23-1347-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Universiteti "Ukshin Hoti", më 02/08/2023, morri këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE DOUBLE I&I SH.P.K. me nr. 2023/0359, e datës 07/06/2023.

2. Mbetet në fuqi vendimi i AK UNIVERSITETI UKSHIN HOTI lidhur me aktivitetin e prokurimit Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Universitetit me numër të prokurimit 10208-23-1347-2-1-1

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik DOUBLE I&I SH.P.K.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 24.04.2023, Universiteti “Ukshin Hoti” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Universitetit” me nr. të prokurimit: 10208-23-1347-2-1-1, të inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti “Ukshin Hoti”.

AK me datën 25. 05. 2023, ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar për kontratë OE “Schafberger JR. Gmbh”.

OE pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit OE Double I&I SH.P.K. me datën 30. 05. 2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 31. 05. 2023, AK - Universiteti “Ukshin Hoti” me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues Double I&I SH.P.K., me datën Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0359, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Shqyrtimi paraprak i ankesës

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 16. 06. 2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues të refuzohet si e bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, i ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës me c’rast AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa OE nuk është pajtuar.

Duke ju referuar veprimeve të ndërmarra si më sipër, Paneli Shqyrtues konsideron se janë plotësuar kushtet për të vendosur në mënyrë meritore mbi këtë çështje, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, duke pasur parasysh faktin se aktet dhe veprimet dhe parashtruesat e palëve, provat në dispozicion dhe raporti i ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me çështjen.

Administrimi dhe vlerësimi i provave

Ankuesi pretendon se AK i ka trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe ka përdorur standarde të dyfishta duke i obliguar ata që të respektojnë dispozitat e Ligjit të Punës e që vet nuk i respektojnë gjatë vlerësimit duke krijuar konfuzitet, vakum dhe manipulim me oferta.

Eksperti shqyrtues i ka sqaruar kriteret e përcaktuara nga AK dhe ato të ofruara nga OE, të cilat sqarime janë të pranueshme për panelin shqyrtues të OSHP-së. Mbi bazën e kësaj, paneli shqyrtues sqaron se tek aneksi 1 i dosjes së tenderit *specifikimet teknike të detyrueshme* është kërkuar: “*Tenderuesi duhet deklarojnë 22 persona dhe të ju ofrojë pagë jo me te ulët mujore se 300 euro sipas vendimit të këshillit drejtues të Universitetit, vendim me numër prot. 01-171 te datës 28.03.2028 dhe duhet që e njëjta ti përfshij të gjitha kontributet pensionale pos pagës*”.

Tutje në kërkesat e dosjes së tenderit është theksuar se obligim i kompanisë që do të fitojë mirëmbajtjen është që konform legjislacionit në fuqi, ti respektojë të drejtat për pushim vjetor, pushim mjekësor, pushim ditor, pushim javor, pushim i lehonisë. Poashtu është kërkuar që të caktohet një menagjer për komunikim me AK dhe që caktimi i menaxherit të bëhet së bashku me ofertë.

Sipas ekspertit shqyrtues, OE i rekomanduar “Schafberger Jr. GmbH - Dega Kosovë në ofertë ka deklaruar se “Me përgjegjësi të plotë se numri i punëtorëve do të jetë minimum 22 punëtorë të caktuar nga Autoriteti Kontraktues të cilët do të paguhën me pagë 300, 00 € duke respektuar të drejtat për pushim vjetor, pushim mjekësor, pushim ditor, pushim javor, pushim i lehonisë”, deklarata kjo e kërkuar në kriteret për vlerësim dhe kushtet për pjesëmarrje.

Duke pasur për bazë sqarimet e dhëna nga eksperti, paneli shqyrtues vlerëson se kjo kërkesë e përcaktuar në kriteret e vlerësimit, është plotësuar nga OE i rekomanduar edhe me kontratat e punëtorëve ku në nenin 7 është i përcaktuar orari i punës dhe në nenin 8 të këtyre kontratave është përcaktuar vlera e pagës.

Paneli shqyrtues poashtu, pas shqyrtimit dhe analizimit të përgjigjes ndaj kërkesës së komisionit të vlerësimit në AK përmes letrës standarde për informata shtesë- tenderë jo normalisht ët ulët, ku është kërkuar të sqarohet se do të arrijnë që ti kryejnë shërbimet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirës së jashtme të universitetit me çmimin e ofruar 0.01 euro për këtë pozicion, dhe sqarimet e marra nga OE i rekomanduar AK i ka konsideruar si të mjaftueshme dhe të pranuar duke e trajtuar ofertën sikurse ofertat tjera për arsyet e dhëna si më poshtë.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk ka shkelur dispozitat e cituara si më sipër, të precizuara dhe të argumentuara ato në ankesë dhe në raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Më tej paneli shqyrtues vlerëson se është në përgjegjësinë e AK-së që të vlerësoj një tender se a është ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta apo jo, dhe se në rastin konkret AK ka vlerësuar se çmimet me të cilat ka ofertuar OE dhe sqarimet e dhëna lidhur me pozicionet që ka ofertuar me këto çmime janë të arsyeshme dhe të pranueshme nga AK.

Paneli Shqyrtues konstaton se duke u bazuar në të dhënat e këtij aktiviteti, ky aktivitet është i llojit të procedurës së hapur, dhe me qenë se kemi sasi indikative për secilin pozicion, PSH konstaton se në këtë rast kemi të bëjmë me ofertë të arsyetuar në aspektin përmbajtësor, dhe poashtu është e evidente që AK në këtë rast nëse konsideron se ka çmime të tilla, mund ti zbatojë instrumentet ligjore që ka në dispozicion para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit sipas RRUOPP, Neni 30.4, menaxhimi i saj sipas kriterëve standardeve dhe sasive të përcaktuara paraprakisht, e poashtu duhet në këtë rast marrim parasysh se OE i rekomanduar mbrapa ofertës së tij duke u zotuar përmbushjen e saj bazuar në dokumentacionin e paraqitur, përveç kësaj duhet konsideruar edhe deklaratat e dorëzuara me ofertën e edhe sanksionet që mund të merren në rast të mos-përmbushjes së kontratës.

Andaj përfundimisht, PSH konstaton se pretendimet ankimore dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, sipas këtij Paneli, gjejnë mbështetje në legjislacionin primar dhe sekondar për prokurimin publik, andaj pohimet ankimore lidhur me mos mbulimin e kostove si dhe lidhur me pozicionin ku OE i rekomanduar ka ofruar me 0,01 për m², konsiderohen si të pabazuara duke u nisur nga fakti se OE ankues nuk ka paraqitur kalkulime të sakta, hulumtime, argumente dhe fakte që vërtetojnë këto pretendime, ndërsa në anën tjetër AK konform legjislacionit në fuqi ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë me të cilat është pajtuar, andaj rrjedhimisht PSH poashtu morri për bazë faktin se çmimet e ofruara nga OE tjerë pjesëmarrës nuk përbëjnë diferencë të madhe në mes të OE pjesëmarrës, për më tepër, edhe vet OE ankues në dy pozicionet e dhëna ka ofertuar me çmim prej 0.26 euro për m², andaj duke u bazuar në të gjitha si më sipër, paneli konstaton se përgjegjësia mbi trajtimin dhe evidentimin e çmimeve të ulëta në raport me mundësinë reale të zbatimit të kontratës bie mbi AK-në, të cilët poashtu kanë në dispozicion mjetet ligjore me të cilat mund të aplikojë në rast dyshimi për realizimin e kontratës, siç është rritja e vlerës së sigurimit të ekzekutimit etj, andaj edhe është arritur deri tek vendim-marrja sikurse në pikën 1 të dispozitivit, në të cilën ankesa aprovohet pjesërisht, për faktin se çmimi i ofruar në pozicionin relevant në dukje dhe paraqitje është i ulët, por në të njëjtën kohë nuk ka ofruar fakte bindëse që vërtetojnë pa-përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar e poashtu OE-ve tjerë pjesëmarrës, me qenë se në këtë aktivitet poashtu kemi dy OE të pasuksesshëm të cilët nuk janë eliminuar por qëndrojnë më me çmim më të ulët se OE ankues, andaj në mënyrë që OE ankues të ketë cilësohej se në mënyrë të plotfuqishme ka interes juridiko-material për të përfituar kontratën në fjalë sipas nenit 4.1.6 të LPP-së, në rastin konkret pretendimet ankimore do duhej të klasifikoheshin si të bazuara kundrejt të gjithë OE pjesëmarrës të pasuksesshëm me çmim më të lirë se OE ankues, ndërsa në pretendimet ankimore si objekt i kësaj ankese, PSH konstaton se OE ankues nuk ka paraqitur pretendime konkrete kundrejt OE

tjerë më të lirë përveç faktin se të njejtit i ka atakuar në formë deklarative vetëm duke i përmendur.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - UNIVERSITETI UKSHIN HOTI**
- **OE - DOUBLE I&I SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: